

V E N D I M
Nr.447, datë 9.7.1998

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË VENDIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE
NR.195, DATË 20.3.1998 “PËR PRIVATIZIMIN E NDËRMARRJEVE QË NUK MUND
TË TRANSFORMOHEN”**

Në mbështetje ligjit nr.8237, datë 1.9.1997 “Për disa ndryshime në ligjin nr.7926, datë 20.4.1995 “Për transformimin e ndërmarrjeve shtetërore në shoqëri tregtare”, ndryshuar me akte të tjera ligjore, me propozimin e Ministrisë së Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në vendimin e Këshillit të Ministrave nr.195, datë 20.3.1998 “Për privatizimin e ndërmarrjeve që nuk mund transformohen” bëhen këto shtesa e ndryshime:

1. Në pikën 2, në fjalinë e parë, pas fjalëve “Të dhënat” hiqet fjala “përkatëse” dhe shtohen fjalët “dhe propozimet përkatëse për privatizim”.

2. Në pikën 2, në fjalinë e dytë, pas fjalëve “Kjo listë ...”, shtohen fjalët “miratohet dhe...”.

3. Në fund të pikës 3 shtohet paragrafi: “kontrata e qirasë”.

4. Pika 4 riformulohet si më poshtë:

“Ministri i Ekonomisë Publike dhe Privatizimit, pasi shqyrton dokumentacionin e privatizimit të ndërmarrjes, të përgatitur sipas pikës 7 të këtij vendimi, nxjerr urdhrin për miratimin dhe publikimin e formës së privatizimit. Ky urdhër së bashku me dokumentacionin përkatës, përcillet në institucionet e përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij vendimi, për kryerjen e procedurave përkatëse”.

5. Në pikën 6 shtohet fjalia “Kontrata e qirasë lidhet sipas përcaktimeve të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.430, datë 9.7.1998 “Për dhënien me qira të objekteve të ndërmarrjeve, shoqërive a institucioneve shtetërore” ”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano